



Primar / Dorezuar Priljena / Pristato Received / Delivered	31. 08 2023	3	viti god year
Organ / Pjesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHK	5908/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 1007/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1007/2023, të datës 19.07.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1; nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur, me datë 31.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1007/2023, e datës 19.07.2023, e parashtruar nga ankuesi.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot.2023/BNJ/225, i datës 27.06.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (tutje vetëm ankuesi), me datë 19.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1007/2023, kundër Vendimit Nr.Prot.2023/BNJ/225, të datës 27.06.2023, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, me pretendimet ankimore se me vendimin e atakuar i është mohuar e drejta e pranimi të përvojës së punës si dhe kompensimi i përvojës së punës, e cila nuk i është reflektuar në pagë dhe pushim vjetor që nga data 25.06.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së

Ankesave, me datë 27.04.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa, ky i fundit, me datë 10.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5281/2023, të datës 19.07.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot.2023/BNJ/225, të datës 27.06.2023 i nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil; Vendimin me numër A.nr.662/2023, të datës 19.06.2023, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Komunikimin elektronik të datës 23.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të AAC-së; Vërtetimin me numër 01/2023 të datës 23.06.202, lidhur më përvojën e punës së ankuesit tek Prapashtica; Komunikimet elektronike të datës 18.07.2023, 17.07.2023, 14.07.2023, 27.06.2023, 23.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të AAC-së; Vendimin me numër protokollit 4589/2023 të datës 05.06.2023 nga Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokollit 3743/2023 të datës 24.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.2023/BNJ/90 të datës 24.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 13.05.1991 nga Arkivi Shtetëror i Kosovës; Shkresën lidhur me kontratën nga Prapashtica të datës 01.09.1991 nga Arkivi Shtetëror i Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.04.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.05.2023 nga Autoriteti i Aviacionit Civil së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 10.05.2023 ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të AAC-së; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 04.05.2023 për ankuesin; Vendimin me Nr.Ref:AACK/ADM/BNJ/13 të datës 03.06.2015 nga Drejtori i Departamentit të Administratës së Burimeve Njerëzore; Komunikimin elektronik të datës 24.03.2023 dhe 22.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të AAC-së; Shkresën zyrtare me Nr.prot.AACC/ADM/SA/7-2 të datës 10.06.2015 nga Drejtori i Departamentit të Administratës së Burimeve Njerëzore së bashku me listën e përvojës së punës për personelin e AAC-së; Shkresën zyrtare me Nr.prot.2015/ZDP/04 të datës 10.06.2015 nga Drejtori i Departamentit të Administratës së Burimeve Njerëzore; Shkresën zyrtare me Nr.prot.AACC/ADM/SA/7-3 të datës 08.07.2015 nga Drejtori i Departamentit të Administratës së Burimeve Njerëzore së bashku me listën e bashkangjitur për vitet e përvojës së punës të personelit të AAC-së; Akt emërimit e ankuesit të datës 10.01.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Deklaratën nën betim të datës 29.06.2015 ndërmjet ankuesit dhe menaxherit të personelit; Vërtetimin e datës 25.06.2015 nga Ndërmarrja private me shumicë dhe pakicë Prapashtica lidhur me përvojën e punës së ankuesit; Kontratën e datës 12.12.2006 të ankuesit tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil; Shkresën zyrtare të datës 27.03.2007 për ankuesin ; Shkresën zyrtare të datës 26.11.2007 për ankuesin , Shkresën zyrtare të datës 14.03.2008 për ankuesin ; Shkresën zyrtare të datës 26.08.2008 për ankuesin Shkresën zyrtare të datës 28.10.2008 për ankuesin ; Vërtetimin për punësim me Nr.156/2015 të datës 21.05.2015 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës; Certifikatën e punës së datës 23.03.2000 nga Swiss Agencit for Development and Cooperation SDC për ankuesin; Kontratën e punësimit të ankuesit të datës 30.03.2009 me AAC-në; Kontratën e punësimit të ankuesit të datës 14.01.2010, me AAC-në; Kontratën e punësimit të ankuesit të datës 16.07.2010, me AAC-në; Kontratën e punësimit të datës 23.12.2010, ndërmjet ankuesit dhe AAC-së; Shkresën zyrtare me numër prot. AAC/05/08 të

datës 22.12.2008; Njoftimin me numër 16/052, të datës 22.07.1991; Shkresën zyrtare të datës 02.12.1998 me numër 3/93 nga Arkivi Shtetëror i Kosovës; Vërtetimet noteriale me numër 3573/2023, 3578/2023, 3569/2023, 3606/2023, nga Zyra noteriale lidhur me saktësinë e dokumenteve për ankuesin; Provat shtesë të parashtruara nga ankuesi të datës 06.06.2023 lidhur me përkthimin e dokumenteve për përvojën e punës; Provat shtesë nga organi i punësimit të datës 12.06.2023 lidhur me pagat e ankuesit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2022 si dhe muajt janar, shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023; Shkresën zyrtare me Nr.2489 të datës 14.05.2015 të Ministrisë së Administratës Publike lidhur me dëshminë mbi njohjen e përvojës së punës; Vendimin VK/2023 të datës 05.06.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill; E-mailin zyrtar të datës 14.06.2023 nga KPMSHCK-ja për AAC-në lidhur me kërkesën për prova shtesë; E-mailin zyrtar të datës 14.06.2023 nga AAC-ja për KPMSHCK-në lidhur me provat shtesë për ankesën e ankuesit si dhe Vendimin me Nr.ref: AACK/ADM/BNJ/13 të datës 03.06.2015 nga Drejtori i Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore të AAC-së, lidhur me pranimin e përvojës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) dhe se i njëjti sipas Aktit të emërimit, të datës 10.01.2012, është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror*, në Departamentin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Njësia e Burimeve Njerëzore të AAC-së, me Vendimin me numër Prot.2023/BNJ/90, të datës 24.03.2023, ka pranuar përvojën e punës së ankuesit total tridhjetenjë (31) viteve, duke përcaktuar se ky vendim nuk ka pasoja juridike prapavepruese, ndërsa, e njëjta pas pranimin të Vendimit A.nr.662/2023, të datës 19.06.2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.06.2023, ka nxjerrë Vendimin me Nr.Prot.2023/BNJ/225, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr.Prot.2023/BNJ/90, të datës 24.03.2023, duke i njohur ankuesit përvojën e punës në total njëzetepesë (25) vite.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se dokumentin/vendimin lidhur me refuzimin e përvojës së punës nga ana e ish Drejtorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në AAC, nuk e ka pranuar asnjëherë deri sa është lëshuar vendimi nga KPMSHCK-ja, ngase sipas tij i njëjti do të kishte parashtruar ankesë më herët, i njëjti ka theksuar se ka qenë i vetmi në institucion që nuk ka pasur vendim të lëshuar në lidhje me përvojën e punës dhe se edhe përkundër faktit se i ka dërguar të gjitha dëshmitë në lidhje me përvojën e punës, Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të AAC-së, ka lëshuar vendim duke mos marrë parasysh edhe sqarimet shtesë nga ana e tij. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet Vendimi me Nr.Prot.2023/BNJ/225 i datës 27.06.2023, i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të AAC-së, dhe të obligoj këtë të fundit për pranimin e përvojës së punës, kompensimin e përvojës së punës në pagë për mbi shtatë (7) vite si dhe ditët e pushimit vjetor po ashtu për mbi shtatë (7) vite, duke filluar nga data 25.06.2023.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit fillimisht ka analizuar Vendimin Nr.06/29 të datës 15.05.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si

dhe Qarkoren Nr.2489 të datës 14.05.2015 të lëshuar nga ana e Ministrisë së Administratës Publike lidhur me njohjen e përvojës së punës para dhe pas Qershorit të vitit 1999. Po ashtu Kolegji i'u referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, e zbatueshme nga data 6 qershor 2023, gjegjësisht Kolegji mori parasysh nenin 6, paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të kësaj rregullore, më të cilin është përcaktuar se: 2. *Përvoja e punës dëshmohet përmes njëres prej dëshmive si vijon: "2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (ML,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-certifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zëhtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim".*


Andaj, në kuptim të dispozitave si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji vlerëson së Njësia e Burimeve Njerëzore të ACC-së, me Vendimin me Nr.Prot.2023/BNJ/225, të datës 27.06.2023, ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, duke zbatuar drejtë dispozitat materiale në fuqi, ngase sipas shkresave të lëndës ankuesi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me përvojën e punës në Swiss Agency for Development and Cooperation/SDC, për periudhën e punës nga 25.01.1999 deri 29.02.2000, përvojën e punës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, për periudhën 01.03.2000 deri 07.11.2006, përvojën e punës në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, për periudhën nga 06.11.2006 deri 31.12.2008, dhe përvojën e punës në Autoritetin e Avacionit Civil nga data 01.01.2009 e tutje, ndërsa, lidhur me përvojën kontestuese të punës së ankuesit në Ndërmarrjen Private me Shumicë dhe Pakicë "Prapashtica", ankuesi ka ofruar Vërtetimin me Nr.01/2023 të datës 23.06.2023 të lëshuar nga Drejtori _____ sipas të cilit thuhet së ankuesi ka punuar në këtë ndërmarrje në cilësinë e zyrtarit për tregti të jashtme, nga data 16.07.1991 deri më 31.12.1998, dhe dokumentet lidhur me regjistrimin e Ndërmarrjes Private me Shumicë dhe Pakicë "Prapashtica", të noterizuar në kuptim të origjinalitetit. Rrjedhimisht, Vërtetimi Nr.01/2023, i datës 23.06.2023, nuk përmban të dhëna identifikuese të nevojshme lidhur me ndërmarrjen si logo, numër identifikues të ndërmarrjes (numër i regjistrimit) apo ndonjë të dhënë tjetër relevante lidhur me ndërmarrjen dhe personin në emër të të cilit është lëshuar vërtetimi dhe së i njëjti nuk shoqërohet me asnjërën nga dokumentet e specifikuar me nenin 6, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1; të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik. Andaj, njohja e përvojës së punës së ankuesit, të Ndërmarrja me Shumicë dhe Pakicë "Prapashtica" mbi bazën e dokumentacionit si më lartë, nuk përbëjnë dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj përvojës së punës, kështu që, pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuar ligjërisht.



Përbledhur si me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1007/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse


Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.